

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Orientalistikë
Titulli i lëndës:	Gjuhë perse 1
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Filologjisë/ UP Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Abdullah hamiti
Detajat kontaktuese:	abdullahamiti@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	Lënda “Gjuhë perse 1” i njofton studentët me karakteristikat themelore të gjuhës perse; fonetika dhe fonologjia e gjuhës perse ku synohet që të aftësohen studentët të shkruajnë dhe të lexojnë drejt gjuhën perse; pas nxënies së sistemit tingullor të gjuhës perse gradualisht kalohet tek kategoritë gramatikore morfologjike (emrat, numri i emrave, përemrat, lidhja gjentive; kohët themelore të foljes; kujdes i veçantë i kushtohet kategorisë së rasave; modelet themelore të fjalisë emërore dhe foljore. Pastaj përpunohen edhe mbiemrat, komparacioni mbiemrave; gjithashtu studentët do të mësojnë për formimin dhe domethënien e formave të ndryshme foljore të gjuhës perse që pastaj të mund t’i lexojnë dhe kuptojnë drejt tekstet perse të zgjedhura për nivelin e tyre dhe të bëjnë analizën gramatikore të teksteve.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka për qëllim që: - t’u ofroj studentëve njohuri të përgjithshme për gramatikën e gjuhës perse - të nxënë fonetikën e fonologjinë e gjuhës perse. - t’u mësojë studentëve morfologjinë e gjuhës perse (sistemi emëror dhe folja ndihmëse dhe kohët themelore të foljeve të rregullta). - Të mësojnë modelet themelore të fjalisë emërore dhe foljore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të duhej të jetë në gjendje që: - të ketë nxënë njohuritë për historinë e gjuhës persiane; - të ketë nxënë shkrimleximin e gjuhës persiane; - të ketë nxënë bazat e morfologjisë persiane; - të jetë në gjendje të lexojë tekste të zgjedhura për

	nivelein e tij.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare			
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			105
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimi është mësim i rregullt me formën e ligjeratave 2 orë në javë dhe poashtu përcillet me punë praktike gjatë ushtrimeve 2 orë në javë. Ushtrimet me studentë ku do të ketë diskutime e dialogje dhe përkthime nga të dy gjuhët persisht-shqip dhe anasjelltas zhvillohen në grup e pastaj kalohet edhe në punë individuale që do të bëhet kryesisht jashtë ambienteve të fakultetit (shtëpi, bibliotekë).		
Metodat e vlerësimit:	Do të zbatohen këto metoda të vlerësimit: Vlerësimi i parë: 15% Vlerësimi i dytë: 15% Angazhimet e tjera 15% Vijimi i rregullt 5% Provimi final: 50% Totali 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<i>Sikiric, Šacir (Dr.), Gramatika perziskog jezika, Sarajevo, 1952;</i> Alavi, Bozorg & Lorenz, Manfred: <i>Lehrbuch der persischen Sprache</i> , Leipzig, 1974. AZFA 1,2,3, doracak për mësimin e gjuhës perse.		

Literatura shtesë:	<i>Dr. Seyed Ali Asghari, ..., Fjalor Persisht – Shqip, Fondacioni Shirazi, Tiranë, 2010</i>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Pasqyrë e zhvillimit historik të gjuhës perse
Java e dytë:	Shkrimi dhe shqiptimi i tingujve: vokalet, diftongjet, konsonantet e gjuhës perse.
Java e tretë:	Akcenti; disa ndryshime fonetike.
Java e katërt:	Emri; shquarsia e emrit, gjinia dhe numri i emrit.
Java e pestë:	Deklinacioni: rasat dhe përdorimi i tyre
Java e gjashtë:	Togfjalëshat; Lidhja gjenitive perse.
Java e shtatë:	a) Mbiemrat pers; komporacioni i mbiemrit: komparativi, superlativi, elativi dhe superlativi absolut; b) Mbiemrat arab në gjuhën perse.
Java e tetë:	Përemrat: Përemrat vetorë, përemrat pronorë, përemrat vetëvetorë, përemrat dëftor, përemrat pyetës, përemrat lidhorë, përemrat e pakufishëm.
Java e nëntë:	Vlerësimi i parë intermediar.
Java e dhjetë:	Numërorët: numërorët themelorë, numërorët rendor, numërorët distributiv, thyesat.
Java e njëmbëdhjetë:	Foljet: Infinitivi, infinitivi i shkurtuar; roli dhe funksioni i infinitivave në fjali; Ndryshimet e konsonanteve dhe të vokaleve të tema foljore.
Java e dymbëdhjetë:	Foljet ndihmëse: Folja “me qenë”, prezenti I foljes ndihmëse “me qenë”, forma enklitike e foljes “me qenë”; renditja e fjalëve në fjali. Ushtrimi I fjalisë së thjeshtë emërore.
Java e trembëdhjetë:	Koha e shkuar, e kryer dhe e ardhme e foljes ndihmëse “me qenë”.
Java e katërmbëdhjetë:	Modelet themelore të fjalisë emërore dhe foljore.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së. Vijimi në ligjërata dhe ushtrime duhet të jetë i rregullt, gjatë mbajtjes së mësimi duhet të mbretërojë qetësia, të shkyçen telefonat celular si dhe hyrja në sallë duhet të jetë me kohë. Plagjiarizmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr note negative.</p>	